



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE SANKSIONEVE

Data: 19.11.2024

Nr: 32

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS NR. 03, DATË 15.11.2024 TË
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.11.2024, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Illirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT: Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ, referuar vendimit nr. 186, datë 08.10.2024 “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023” të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21, pika 1, shkronja “dh”, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar



Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën për vendosje sanksioni administrativ, e cila është regjistruar në regjistrin e kërkesave për masat disiplinore, me nr. 03 regj., datë 15.11.2024. Në mbledhjen e datës 19.11.2024, ora 12:00, pas relatimit të z. Ledio Braho, u konstatua se kërkesa i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 35, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” dhe në mbështetje të nenit 45, pika 1, shkronja “c”, kërkesa duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 03, datë 15.11.2024 të paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 03.12.2024, ora 11:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe përfundon me çeljen e seancës së shqyrtimit në themel, sipas shkronjës “b”, të nenit 68 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar